

Emertimi dhe Forma ligjore: "Isobar Construction" sh.p.k  
NIPT –i: L12210036D  
Adresa e Selise: Tirane  
Data e krijimit: 10.10.2011  
Veprimtaria Kryesore: Ndertim – Projektim, Rikonstruksione

## PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2  
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare")

### VITI 2018

Pasqyrat Financiare jane individuale  
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek  
Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura  
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2018-31.12.2018  
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 29.01.2019

Pasqyra e Pozicionit financiar

<b>AKTIVE</b>	<b>Shenime</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<b>Aktivet monetare</b>	<b>4</b>	<b>6,617,334</b>	<b>181,438</b>
Investime		-	-
<b>Të drejta të arkëtueshme</b>		-	-
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimit</i>		21,106,034	30,854,778
<i>Tvsh kreditore</i>		21,532,361	17,254,182
<i>Tatim fitimi I mbipaguar</i>		1,707,572	810,898
<i>Te tjera</i>		-	-
<b>Totali I te drejtave te arketueshme</b>	<b>5</b>	<b>44,345,967</b>	<b>48,919,858</b>
<b>Inventarët</b>		-	-
<i>Lende e pare dhe materiale</i>		535,158	3,105,125
<i>Parapagime per inventar</i>		-	-
<b>Totali I inventarit</b>	<b>6</b>	<b>535,158</b>	<b>3,105,125</b>
<b>Shpenzime të shtyra</b>	<b>7</b>	<b>156,491</b>	<b>3,980,788</b>
<b>Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara</b>		-	-
<b>Totali I aktiveve afatshkurtra</b>		<b>51,654,951</b>	<b>56,187,208</b>
<b>Aktive financiare</b>		-	-
<b>Aktivet materiale</b>		-	-
<i>Mjete transporti</i>		16,157,898	16,967,116
<i>Te tjera pajisje</i>		2,227,094	2,100,279
<i>Pajisje zyre</i>		2,984,203	2,010,920
<b>Shuma e aktiveve materiale</b>	<b>8</b>	<b>21,369,195</b>	<b>21,078,315</b>
<b>Aktivet biologjike</b>		-	-
<b>Aktive jo materiale:</b>		-	-
<b>Aktive tatimore të shtyra</b>		-	-
<b>Kapitali i nënshkruar i papaguar</b>		-	-
<b>Totali I aktiveve afatgjata</b>		<b>21,369,195</b>	<b>21,078,315</b>
<b>Total Aktive</b>		<b>73,024,146</b>	<b>77,265,523</b>

Administratori

ALBAN TARELLI  
Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

## Pasqyra e Pozicionit financiar

<b>PASIV</b>	<b>Shenime</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
<b>Detyrime afatshkurtra:</b>			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		22,291,787	30,406,739
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		2,410,003	2,509,081
<i>Të pagueshme për detyrimet tatimore</i>		334,365	359,061
<i>Te pagueshme te tjera</i>		-	-
<i>Te pagueshme ndaj institucioneve te kredise</i>		-	-
<b>Shuma e detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>9</b>	<b>25,036,155</b>	<b>33,274,880</b>
<b>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</b>		-	-
<b>Të ardhura të shtyra</b>		-	-
<b>Provizione</b>		-	-
<b>Total detyrime afatshkurtra</b>		<b>25,036,155</b>	<b>33,274,880</b>
<b>Detyrime afatgjata:</b>			
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>		-	3,126,838
<i>Të pagueshme për shpenzime të konstatuara</i>		-	-
<i>Të ardhura të shtyra</i>		-	-
<i>Provizione</i>		-	-
<i>Detyrime tatimore të shtyra</i>		-	-
<b>Total detyrime afatgjata</b>	<b>10</b>	<b>-</b>	<b>3,126,838</b>
<b>Total detyrime</b>		<b>25,036,155</b>	<b>36,401,718</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>		-	-
<b>Kapitali i Nënshkruar</b>		40,863,000	100,000
<b>Rezerva te tjera</b>		806	32,148,297
<b>Fitim / Humbja e Vitit</b>		7,124,186	8,615,508
<b>Total kapitali aksionar</b>	<b>11</b>	<b>47,987,991</b>	<b>40,863,805</b>
<b>Totali I kapitalit dhe I detyrimeve</b>		<b>73,024,146</b>	<b>77,265,523</b>

Administratori

ALBAN TARELLI  
Alban Tarelli

Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

Pasqyra e performances	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	108,238,489	105,404,254
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	13	1,333,750	-
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>	<b>14</b>	<b>(50,570,084)</b>	<b>(62,352,390)</b>
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>		(25,110,105)	(48,274,522)
<i>Të tjera shpenzime</i>		(25,459,979)	(14,077,868)
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>15</b>	<b>(14,880,532)</b>	<b>(17,580,091)</b>
<i>Paga dhe shpërblime</i>		(12,751,104)	(15,065,877)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore</i>		(2,129,428)	(2,514,214)
<b>Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale</b>		-	-
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	16	(4,632,785)	(4,676,164)
<i>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</i>	17	(30,225,062)	(9,891,045)
<b>Të ardhura të tjera</b>		-	33,550
<b>Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare</b>		-	-
<b>Shpenzime financiare</b>	<b>18</b>	<b>(844,335)</b>	<b>(696,908)</b>
<i>Shpenzime per interesa</i>		(183,637)	(268,148)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		-	-
<i>Fitime/humbje nga kurset e kembimit</i>		(459,346)	168,022
<i>Te ardhura (gjoba te arketuara)</i>		-	-
<i>Gjoha dhe interesa</i>		(201,352)	(596,781)
<b>Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet</b>		-	-
<i>Fitimi/Humbja para tatimit</i>	19	8,419,441	10,241,206
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>	<b>19</b>	<b>(1,295,255)</b>	<b>(1,625,698)</b>
<i>Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin</i>		(1,295,255)	(1,625,698)
<b>Fitimi/Humbja e vitit</b>	<b>19</b>	<b>7,124,186</b>	<b>8,615,508</b>
<b>Te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>7,124,186</b>	<b>8,615,508</b>

Administratori

Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare	Shenime	(metoda indirekte)	
		31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>		-	-
<i>Fitim / Humbja e vitit</i>		8,419,441	10,241,206
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>		4,632,785	4,676,164
<i>Vlera kontabel e aktiveve te shitura</i>		870,632	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		3,824,297	(1,678,175)
<i>Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>		5,470,565	1,600,022
<i>Rënie/(rritje) në inventarë</i>		2,569,967	4,782,042
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>		(8,238,726)	(13,403,505)
<i>Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit</i>		-	-
<i>Tatim fitimi I paguar</i>		(2,191,929)	(2,489,866)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>		<b>15,357,031</b>	<b>3,727,889</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		-	-
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>		(5,794,298)	(2,958,507)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		<b>(5,794,298)</b>	<b>(2,958,507)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		(3,126,838)	(698,002)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		<b>(3,126,838)</b>	<b>(698,002)</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare</b>		<b>6,435,897</b>	<b>71,380</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>		<b>181,438</b>	<b>110,058</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>		<b>6,617,334</b>	<b>181,438</b>

Administratori

*ALBAN TARELI*  
Alban Tareli



Hartuesi i pasqyrave

*ANITA PULAJ*  
Anita Pulaj

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali I regjistruar	Rezerva te tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016</b>	<b>100,000</b>	<b>20,603,823</b>	<b>11,544,474</b>	<b>32,248,297</b>
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël				
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>				
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	8,615,508	8,615,508
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>				
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:</b>				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	-	11,544,474	(11,544,474)	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>				-
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2017</b>	<b>100,000</b>	<b>32,148,297</b>	<b>8,615,508</b>	<b>40,863,805</b>
<b>Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:</b>				-
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	7,124,186	7,124,186
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:</b>				-
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>				-
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:	40,763,000	(32,147,491)	(8,615,508)	-
<b>Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike</b>				-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018</b>	<b>40,863,000</b>	<b>806</b>	<b>7,124,186</b>	<b>47,987,991</b>

Administratori

ACBAN  
Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj

## SHENIMET SHPJEGUESE

### 1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria « **Isobar Construction** » shpk është regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar me datë 10.10.2011, me ortak dhe administrator të vetëm Z. Alban Tarelli. Kapitali i shoqërisë është 40,863,000 leke dhe kuota e tij zotërohet 100% nga ortaku I vetëm.

Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e ndërtimit, rikonstrukcione dhe gjate vitit 2018 ka patur mesatarisht 39 të punësuar.

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 "*Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

### 2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

#### 2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "*Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre*", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

#### 2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

#### 2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

#### 2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

#### 2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë të raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

##### 2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/LEK	107.82	111.10

### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e



parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare

vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4 Aktive afatgjata materiale

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të Tjera	Vlera e mbetur	20%

#### iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### 3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### 3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### 3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### 3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe

detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatuashëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### 3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### 3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

## Bilanci Kontabel, aktivet

### 4. Aktivet monetare

Aktivitet monetare janë në shumën 6,617,334 leke, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Likuiditete	Viti 2018	Viti 2017
1	Depozita në banke	489,330	162,398
2	Para në arke	6,128,004	19,040
	<b>Totali</b>	<b><u>6,617,334</u></b>	<b><u>181,438</u></b>

Depozitat në banke në monedhe të huaja janë të konvertuara me kursin e datës 31.12.2018, diferencat nga kursi i kembimit janë të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

**5. Te drejta te arketueshme**

Paraqitet shuma e kerkesave te arketueshme prej 44,345,967 leke deri me 31.12.2018, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Klient per shitje e sherbime	21,106,034	30,854,778
2	Tvsh	21,532,361	17,254,182
3	Tatim fitimi	1,707,572	810,898
	<b>Totali</b>	<b><u>44,345,967</u></b>	<b><u>48,919,858</u></b>

**6. Inventarët**

Ne kete post paraqitet me 31.12.2018 inventari i materialeve ne shumen 535,158 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Materiale ndertimi	535,158	3,105,125
	<b>Totali</b>	<b><u>535,158</u></b>	<b><u>3,105,125</u></b>

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2018 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

**7. Shpenzime të shtyra**

Ne kete post paraqitet me 31.12.2018 shpenzime te cilat i perkasin periudhave te ardhshme ne shumen 156,491 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime te shtyra	156,491	3,980,788
	<b>Totali</b>	<b><u>156,491</u></b>	<b><u>3,980,788</u></b>

**8. Aktive materiale**

Aktivitet afat gjata materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 21,369,195 leke, sipas tabelës se meposhtme :

Emertimi	Mjete transporti	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
<b>Aktive afat gjata materiale</b>				
Gjendja me 31.12.2017	25,087,753	4,117,940	3,102,182	32,307,875
Shtesat per 2018	3,481,333	733,917	1,579,047	5,794,298
Paksimet per 2018	(1,016,667)	(466,880)	-	(1,483,547)
Gjendja me 31.12.2018	<b><u>27,552,419</u></b>	<b><u>4,384,977</u></b>	<b><u>4,681,229</u></b>	<b><u>36,618,625</u></b>
<b>Amortizimi I AQT-ve</b>				
Gjendja me 31.12.2017	8,120,637	2,017,662	1,091,263	11,229,562
Shtesat per 2018	3,628,921	398,100	605,765	4,632,785
Paksimet per 2018	(355,037)	(257,880)	-	(612,917)
Gjendja me 31.12.2018	<b><u>11,394,521</u></b>	<b><u>2,157,882</u></b>	<b><u>1,697,028</u></b>	<b><u>15,249,431</u></b>
<b>Vlera neto 31.12.2018</b>	<b><u>16,157,898</u></b>	<b><u>2,227,094</u></b>	<b><u>2,984,203</u></b>	<b><u>21,369,195</u></b>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017.

**Bilanci kontabel, pasivet****9. Detyrime afatshkurtra**

Paraqiten detyrimet afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2018 ne shumen 25,036,155 leke.

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2018	Viti 2017
1	Detyrime per furnitore	22,291,787	30,406,739
2	Detyrime per paga	2,410,003	2,509,081
3	Detyrime tatimore	334,365	359,061
	<b>Totali I detyrimeve</b>	<b><u>25,036,155</u></b>	<b><u>33,274,880</u></b>

**9.1 Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit**

Paraqitet gjendja e palikujduar e furnitoreve me 31.12.2018 ne shumen 22,291,787 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2018 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

**9.2 Te pagueshme ndaj punonjesve**

Paraqitet detyrimi qe shoqeria ndaj punonjesve per paga te palikujduara deri me 31.12.2018 ne shumen 2,410,003 leke.

**9.3 Të pagueshme për detyrimet tatimore**

Jane pasqyruar detyrimet e shoqerise ndaj shtetit jane ne shumen 334,365 leke si me poshte:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2018	Viti 2017
1	Sigurime shoqerore dhe shendetsore	263,453	337,516
2	Tatimi mbi te ardhurat personale	18,200	14,300
3	Tatim ne burim	7,245	7,245
4	Detyrime per gjoba e penalitete	45,467	-
	<b>Totali I detyrimeve</b>	<b><u>334,365</u></b>	<b><u>359,061</u></b>

**10. Detyrime Afatgjata**

Shoqeria e ka shlyer gjate vitit ushtrimor 2018 detyrimin per qera financiare dhe me 31.12.2018 paraqitet si me poshte:

Nr	Detyrimet afatgjata	Viti 2018	Viti 2017
1	Qera financiare	-	3,126,838
	<b>Totali I detyrimeve</b>	<b><u>-</u></b>	<b><u>3,126,838</u></b>

**11. Kapitali**

Gjate vitit 2018 jane shtuar kapitalet e veta me fitimin e vitit ne shumen 7,124,186 leke. Shoqeria ka regjistruar ne QKB proceduren per zmadhimin e kapitalit te saj ne shumen 40,763,000 leke, duke arritur kapitali i regjistruar i saj ne shumen 40,863,000 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise me 31.12.2018 eshte 47,987,991 leke.

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2017	100,000	32,148,297	8,615,508	40,863,805
2	Shtesat per 2018	40,763,000	-	7,124,186	47,887,186
3	Pakesimet per 2018	-	(32,147,491)	(8,615,508)	(40,762,999)
	<b>Gjendja me 31.12.2018</b>	<b><u>40,863,000</u></b>	<b><u>806</u></b>	<b><u>7,124,186</u></b>	<b><u>47,987,991</u></b>

## Pasqyra e performances

## 12. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Paraqiten te ardhurat e realizuara nga aktiviteti per vitin ushtrimor 2018 ne shumen 108,238,489 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga aktiviteti	108,238,489	105,404,254
	<b>Totali I te ardhurave</b>	<b><u>108,238,489</u></b>	<b><u>105,404,254</u></b>

Sqarim per raportimin e shitjeve ne rubriken "Furnizime me shkalle 0%":

Ju sqarojme se shuma e te ardhurave prej 69,670,499 leke, e raportuar ne rubriken "Furnizime me shkalle 0%" perfaqeson vleren e sherbimeve qe shoqeria ka kryer per punimet ne Hidrocentralin e Banjes, per shoqerine "Limak" shoqeri nenkontratore e "Devoll Hydropower", e cila ka te drejte te emeruje nenkontratore te nivelit te 2-te (Isobar Construction), nga ku lind e drejta per te pergatitur fatura te cilat do te jene me TVSH 0% dhe do te pasqyrohen ne rubriken "Furnizime me shkalle 0%" me shenimin perkates "Sipas regjimit specifik të TVSH-së sipas ligjit Nr. 105/2013 date 28.03.2013".

## 13. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

Paraqiten te ardhurat e realizuara te tjera te shfrytezimit per vitin ushtrimor 2018 ne shumen 1,333,750 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga shitja e aktiveve	1,203,846	-
2	Te ardhura nga rivleresimi tatimor	129,904	-
	<b>Totali I te ardhurave</b>	<b><u>1,333,750</u></b>	<b><u>-</u></b>

## 14. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2018 eshte 50,570,084 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Blerje materiale	22,540,138	43,492,480
2	Ndryshim gjendje	2,569,967	4,782,042
	<b>Shuma e mat. Te konsumuara</b>	<b><u>25,110,105</u></b>	<b><u>48,274,522</u></b>
	<b>Te tjera shpenzime</b>		
1	Karburant	12,141,486	14,057,911
2	Shpenzime te tjera	-	19,957
3	Sherbime nga te tretet	13,318,493	-
	<b>Shuma e shpenzimeve te tjera</b>	<b><u>25,459,979</u></b>	<b><u>14,077,868</u></b>
	<b>Totali</b>	<b><u>50,570,084</u></b>	<b><u>62,352,390</u></b>

## 15. Shpenzime te personelit

Shpenzimet per personelin paraqiten ne shumen 14,880,532 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime per paga	12,751,104	15,065,877
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	2,129,428	2,514,214
	<b>Shuma</b>	<b><u>14,880,532</u></b>	<b><u>17,580,091</u></b>

**16. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi**

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e aseteve sipas normave ligjore ne fuqi ne shumen 4,632,785 leke.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Amortizimi I aktiveve	4,632,785	4,676,164
	<b>Shuma</b>	<b><u>4,632,785</u></b>	<b><u>4,676,164</u></b>

**17. Shpenzime te tjera shfrytezimi**

Ne kete ze jane ne shumen 30,225,062 leke, te perfshira si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Sherbim kontabel e auditimi, ligjor	570,000	614,502
2	Sigurime mjetesht	119,302	283,237
3	Materiale ndihmese, veshje pune	13,515,191	6,283,401
4	Kancelari	40,257	8,295
5	Qera	579,600	579,600
6	Shpenzime telefonike	220,269	213,841
7	Sherbime bankare	24,609	19,836
8	Taksa vendore	67,000	67,000
9	Shpenzime dieta per personelin	11,485,000	-
10	Riparime mjetesht	2,536,613	1,817,833
11	Sherbim parkimi	14,240	3,500
12	Shpenzime hoteli	162,600	-
13	Vlera kontabel e aseteve te shitura	870,632	-
14	Te tjera	19,750	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>30,225,062</u></b>	<b><u>9,891,045</u></b>

**Kuadrimi I blerjeve me shpenzimet e paraqitura ne bilanc**

Ne tabelen e meposhtme paraqitet kuadrimi I blerjeve te pasqyruara ne FDP mujore me shpenzimet e perfshira ne pasqyrat financiare per vitin 2018.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje te perjashtuara	9,428,120
2	Blerje investimi pa tvsh	589,180
3	Blerje nga furnitore vendas	55,583,681
4	Blerje te investimit brenda vendit me tvsh 20 %	5,205,119
	<b>Totali I blerjeve</b>	<b><u>70,806,100</u></b>
Nr	Sipas bilancit	
1	Blerje materialesh	22,540,138
2	<i>korrigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	2,569,967
3	Te tjera Shpenzime	25,459,979
3	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	30,225,062
4	Blerje AQT	5,794,299
5	Shpenzime per interesa (me fature)	183,638
	<b>Shuma</b>	<b><u>86,773,083</u></b>



Diferenca	15,966,983
Korrigjohet me shpenzimet pa fature	
1 Taksa lokale	(67,000)
2 Sherbime bankare	(24,609)
3 Rimarrje shpenzime te shtyra 2017	(3,980,788)
4 Vlera kontabel e Aqt-ve te shitura	(870,632)
5 Kalim shpenzime te shtyra 2018	156,491
6 Qera financiare	2,874,522
7 Dieta personeli	(11,485,000)
<b>Diference FDP-Bilanc</b>	<b>0</b>

### 18. Shpenzime Financiare

Paraqiten shpenzime ne shumen 844,335 leke per vitin 2018, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Gjoha e penalitete	(45,467)	(596,781)
2	Shpenzime per interesa Leasing	(183,637)	(268,148)
3	Fitime nga kursi I kembimit	(459,346)	168,022
4	Humbje nga mosarketim klienti	(155,885)	-
	<b>Totali</b>	<b>(844,335)</b>	<b>(696,908)</b>

### 19. Llogaritja e rezultatit tatimor

Ne tabelen me poshte paraqitet llogaritja e rezultatit tatimor per vitin 2018. Shoqeria per vitin ushtrimor 2018 paraqitet me nje fitim neto prej 7,124,186 leke.

Nr	EMERTIMI	VITI 2018	VITI 2017
1	Te ardhura nga aktiviteti	108,238,489	105,404,254
2	Te ardhura te tjera te shfrytezimit	1,333,750	-
	<b>Totali I te ardhurave</b>	<b>109,572,239</b>	<b>105,404,254</b>
3	Shpenzime	(101,152,798)	(95,163,048)
4	Rezultati i ushtrimit	<b>8,419,441</b>	<b>10,241,206</b>
5	Shpenzime te pazbritshme	<b>215,592</b>	<b>596,781</b>
6	Rezultati tatimor	<b>8,635,033</b>	<b>10,837,987</b>
7	Tatim fitimi	(1,295,255)	(1,625,698)
	<b>Fitimi neto</b>	<b>7,124,186</b>	<b>8,615,508</b>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 215,592 leke jane shpenzime te detajuara si me poshte :

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Gjoha e penalitete	45,467	596,781
2	Humbje mosarketim klienti	155,885	-
3	Parkim autoveture	14,240	-
	<b>Totali</b>	<b>215,592</b>	<b>596,781</b>

## 20. Angazhime dhe pasiguri

### Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2018 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

## 21. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

ALBAN TARELLI  
Alban Tarelli



Hartuesi i pasqyrave

Anita Pulaj